



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.177

dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 494 datë 22.12.2011	Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor	10021
Ligj nr.10 495 datë 22.12.2011	Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit)”, dhe të dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar”	10028
Ligj nr.10 496 datë 22.12.2011	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”	10029
Vendim i Kuvendit nr.147, datë 22.12.2011	Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”	10029
Vendim i Kuvendit nr.148, datë 22.12.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	10030
Vendim i Kuvendit nr.149, datë 22.12.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	10030
Vendim i Kuvendit nr.150, datë 22.12.2011	Për zgjedhjen e Avokatit të Popullit	10031
Dekret nr.7191 datë 20.12.2011	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	10031

Udhëzim i KMDHP nr.16, datë 26.12.2011	Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë”	10032
Vendim i ERE nr.123, datë 25.11.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve	10037
Vendim i ERE nr.155, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesi i palëve të treta të paraqitur nga ana e kompanisë TAP	10039
Vendim i ERE nr.156, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Stravaj Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Stravaj	10039
Vendim i ERE nr.157, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec Stravaj Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	10040
Vendim i ERE nr.158, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Vertop”	10041
Vendim i ERE nr.159, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	10042
Vendim i ERE nr.160, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me seri pv10k, nr.104, lëshuar me vendim te Bordit te Komisionerëve të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010 për shoqërinë “Wenerg” sh.a.....	10043
Vendim i ERE nr.161, datë 19.12.2011	Për fillimin e procedurave për rishikimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike	10044

LIGJ
Nr.10 494, datë 22.12.2011

**PËR MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE TË PERSONAVE, TË CILËVE
U KUFIZOHET LËVIZJA ME VENDIM GJYQËSOR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për realizimin e mbikëqyrjes elektronike, në funksion të kontrollit të zbatimit të urdhërimeve që përmban një vendim gjyqësor, që cakton një nga alternativat e dënimit me burgim, dënim plotësues, një nga llojet e masave shtrënguese, apo një urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rritja e sigurisë publike dhe garantimi i ekzekutimit efektiv të vendimeve gjyqësore.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Mbikëqyrje elektronike ose ME” është mekanizmi që garanton zbatimin efektiv të vendimit gjyqësor, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij.

b) “Organi që realizon ME-në” është personi juridik, publik ose privat, që realizon ME-në, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

c) “Pajisje” është mjeti elektronik i vendosur në trupin e subjektit dhe që mundëson përcaktimin në kohë reale të vendndodhjes së tij.

ç) “Person i afërt” është personi që ka lidhje të afërta familjare deri në shkallë të tretë me subjektin dhe/ose jeton në të njëjtën banesë me të.

d) “Sallë operative” është zyra e krijuar nga organi që realizon ME-në për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave që vijnë nga pajisja dhe që mundëson kontrollin e zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor nga subjekti.



- dh) “Subjekt” është personi i vendosur nën ME, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
e) “Viktimë” është personi, ndaj të cilit është ushtruar dhunë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Neni 4 Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave, ndaj të cilëve, me vendim gjyqësor, është:

- a) vendosur një nga masat shtrënguese, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c” dhe “d” të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale;
b) vendosur një nga alternativat e dënimit me burgim, të parashikuara nga nenet 58, 59, 59/a dhe 64 të Kodit Penal;
c) vendosur dënimi plotësues i përcaktuar në paragrafin e shtatë të nenit 30 të Kodit Penal;
ç) lëshuar, me vendim gjyqësor, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Neni 5 Parimet e ME-së

Veprimtaria e organeve të ME-së bazohet në parimin e:

- a) ligjshmërisë;
b) mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike;
c) garantimit të lirisë personale të të dëmtuarit nga vepra penale apo të viktimës;
ç) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, dinjitetit njerëzor dhe sigurisë personale të subjektit të ligjit;
d) mosdiskriminimit;
dh) proporcionalitetit të ME-së me rrethanat e rastit dhe personalitetin e subjektit;
e) objektivitetit dhe efektivitetit.

KREU II PËRDORIMI I ME-SË

Neni 6 Nisma për përdorimin e ME-së

Gjykata vendos përdorimin e ME-së, kryesisht ose me kërkesën e prokurorit, subjektit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës apo prindërve ose kujdestarit të të miturit.

Neni 7 Pëlqimi i subjektit

1. Gjykata, përpara caktimit të masave shtrënguese, shpalljes së vendimit përfundimtar të gjykatës, apo lëshimit të urdhrat të mbrojtjes ose urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, pyet subjektin nëse jep pëlqimin për përdorimin e ME-së dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj.

2. Përdorimi i ME-së vendoset vetëm me pëlqimin e subjektit dhe pasi gjykata sigurohet se ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i ME-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

3. Pëlqimi i subjektit për përdorimin e ME-së jepet me shkrim ose nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore. Në rastin e subjekteve të mitura, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor.

4. Nëse subjekti nuk jep pëlqimin, sipas pikës 3 të këtij neni, gjykata nuk mund të urdhërojë përdorimin e ME-së, por ky fakt mbahet në konsideratë prej saj, së bashku me rrethanat e tjera të çështjes, në përcaktimin e masës shtrënguese apo dënimit.

5. Përjashtimisht, gjykata mund të vendosë përdorimin e ME-së, edhe pa pëlqimin e subjektit, në rastin e parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 4 të këtij ligji, nëse vlerëson se është e domosdoshme për të garantuar të drejtat kushtetuese të të tretëve dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova, se subjekti paraqet rrezikshmëri për cenimin e këtyre të drejtave. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, vetëm nëpërmjet ankimit të vendimit gjyqësor që lëshon urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, sipas parashikimeve të nenit 21 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

Neni 8

Caktimi i personit të afërt

Kur është e mundur, subjekti përcakton edhe një person të tij të afërt, i cili ndihmon në zbatimin e vendimit për përdorimin e ME-së. Nëse jep pëlqimin të caktohet si i tillë, personi i afërt ka detyrimin të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon ME-në adresën e tij të saktë dhe numra telefoni kontakti, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë.

Neni 9

Vendimi për përdorimin e ME-së

1. Përdorimi i ME-së urdhërohet nga gjykata në vendimin gjyqësor të dhënë ndaj subjekteve, në rastet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Gjkata, gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit, në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 4 të këtij ligji, i kërkon Shërbimit të Provës një raport vlerësimi për të pandehurin dhe nevojën e përdorimit të ME-së.

3. Përdorimi i ME-së mund të jetë me ose pa afat. Nëse gjykata nuk ka përcaktuar afat, kohëzgjatja e përdorimit të ME-së është e barabartë me kohëzgjatjen e masës shtrënguese, alternativës së dënimit me burgim, urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

Neni 10

Përmbajtja e vendimit

Vendimi gjyqësor që urdhëron përdorimin e ME-së, përveç sa parashikohet në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, duhet të përmbajë, sipas rastit, edhe:

a) dhënien e pëlqimit nga subjekti, kur këtë e kërkon ligji, dhe/ose prindërit apo kujdestari i të miturit, për përdorimin e ME-së;

b) zonat e lejuara dhe zonat e ndaluara të lëvizjes së subjektit;

c) detyrimin e subjektit për të qëndruar brenda zonës së lejuar ose për të mos hyrë në zona të ndaluara;

ç) kohën e përdorimit të ME-së, nëse gjykata urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar.



KREU III REALIZIMI I ME-SË

Neni 11

Organi që realizon ME-në

1. Organi që realizon ME-në është përgjegjës për vendosjen, heqjen dhe funksionimin e rregullt të pajisjes. Vendi, koha dhe rregullat për vendosjen dhe heqjen e pajisjes përcaktohen në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të nxjerrë nga prokurori ose gjykata, të cilët ia njoftojnë menjëherë subjektit dhe organit që realizon ME-në.

2. Organi që realizon ME-në, nëpërmjet sallës operative të ngritur prej tij, mbledh, përpunon dhe raporton të dhënat që vijnë nga pajisja.

3. Kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon ME-në, rregullat për përzgjedhjen e tij, si dhe të drejtat e detyrimet e tij caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Shërbimi i Provës

1. Shërbimi i Provës është organ përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të ME-së.

2. Shërbimi i Provës, në mënyrë periodike, informon Ministrinë e Drejtësisë për kontrollet e ushtruara për mënyrën e realizimit të ME-së.

3. Shërbimi i Provës vendos, çdo javë, në dispozicion të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit, të dhëna të përditësuara për numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim dhe mundësinë teknike të realizimit të ME-së.

4. Metodologjia dhe rregullat e ushtrimit të kontrolleve të Shërbimit të Provës për mënyrën e realizimit të ME-së, periodicitetit dhe përmbajtja e informacionit të përcjellë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rregullat për paraqitjen e të dhënave të përditësuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 13

Pajisja për realizimin e ME-së

1. ME-ja realizohet nëpërmjet vendosjes së një pajisjeje të posaçme në trupin e subjektit, e cila duhet:

a) të ketë përmasa të vogla, në mënyrë që të mbulohet lehtësisht nga veshjet dhe të mos shikohet nga të tretët;

b) të mos lëshojë tinguj ose dritë;

c) të përbëhet nga materiale të parrezikshme për jetën dhe shëndetin e subjektit dhe të të tretëve;

ç) të vendoset në një pjesë të trupit që e bën të pamundur shikimin e saj nga të tretët;

d) të lejojë subjektin të kryejë pa vështirësi të gjitha veprimtaritë e tij të zakonshme.

2. Pajisja duhet të plotësojë karakteristikat teknike të mëposhtme:

a) të jetë në gjendje të transmetojë sinjal nga çdo pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) të ketë rezistencë të lartë ndaj elementeve natyrore, e cila mundëson funksionimin normal edhe gjatë ekspozimit ndaj tyre;

c) të jetë e vështirë për t'u hequr;

ç) të transmetojë sinjal të posaçëm nëse dëmtohet ose hiqet.

Neni 14
Salla operative

1. Informacioni i siguruar nga pajisja i transmetohet drejtpërdrejt sallës operative, e cila funksionon pa ndërprerje.

2. Salla operative duhet të ketë aftësinë teknike të marrë në kohë reale informacionin për vendndodhjen e subjekteve që ndodhen brenda territorit ku ushtron kompetencën organi që realizon ME-në.

3. Organi që realizon ME-në siguron funksionimin pa ndërprerje të sallës operative dhe lidhjen e saj në kohë reale me pajisjen që përcakton vendndodhjen e subjektit.

Neni 15
Informacioni i transmetuar sallës operative

1. Informacioni i siguruar nga pajisja shfaqet në harta, të cilat mundësojnë perceptimin e vendndodhjes së subjektit në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me sistemin rrugor dhe administrativ të Republikës së Shqipërisë.

2. Shfaqja e informacionit në harta dhe perceptimi pamor i tij është i ndaluar nëse subjekti qëndron brenda zonës së lejuar ose jashtë zonës së ndaluar të lëvizjes.

3. Informacioni për vendndodhjen e subjektit shfaqet në hartë vetëm në rast se:

a) subjekti del nga zona e lejuar ose hyn në zonën e ndaluar të lëvizjes, sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor që urdhëron përdorimin e ME-së;

b) salla operative, nëpërmjet organit që realizon ME-në, merr një kërkesë nga Shërbimi i Provës ose Policia e Shtetit, të cilët kërkojnë të përcaktojnë vendndodhjen e subjektit për shkak se:

i) subjekti dyshohet se ka shkelur kushtet e vendosura në vendimin gjyqësor;

ii) duhet të evitohet një rrezik i mundshëm që i kanoset subjektit ose të tretëve;

iii) subjekti duhet të kontaktohet menjëherë për t'u pyetur apo për ndonjë qëllim tjetër të ligjshëm;

c) organi që realizon ME-në, nëpërmjet sallës operative, ka arsye të motivuar të besojë se:

i) subjekti mund të ketë dëmtuar ose hequr pajisjen;

ii) pajisja ka pësuar një dëmtim aksidental dhe nuk transmeton informacion si duhet.

4. Informacioni që shfaqet në hartë u vihet në dispozicion, në kohë reale, me terminal të dedikuar, Policisë së Shtetit dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve.

Neni 16
Konfidencialiteti i informacionit

1. Organi që realizon ME-në, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, respekton rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Informacioni i siguruar për vendndodhjen e subjektit është i ndaluar t'u jepet personave të tretë apo agjencive ose organeve të paautorizuara nga ky ligj.

KREU IV
ZBATIMI I VENDIMIT PËR PËRDORIMIN E ME-SË

Neni 17
Detyrimet e subjektit

Subjekti detyrohet:

a) të zbatojë kushtet e përcaktuara në vendimin gjyqësor;



b) të vendosë në dispozicion të gjykatës, prokurorit dhe organit që realizon ME-në adresën e saktë të banimit dhe të punës, si dhe numra telefonikë kontakti, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë;

c) të kthehet brenda zonës së lejuar të lëvizjes ose të largohet nga zona e ndaluar, brenda 30 minutave nga çasti kur është kontaktuar nga salla operative;

ç) të mos dëmtojë ose heqë në asnjë rast pajisjen;

d) të njoftojë menjëherë organin që realizon ME-në për çdo dëmtim aksidental të pajisjes ose funksionimin në kushte jonormale të saj.

Neni 18

Veprime në rast të shkeljes së vendimit gjyqësor

1. Kur informacioni në hartë evidenton daljen nga zona e lejuar ose hyrjen në zonën e ndaluar të lëvizjes, si edhe dëmtimin ose heqjen e pajisjes, salla operative kontakton menjëherë subjektin. Nëse ky i fundit nuk mund të kontaktohet, atëherë salla operative kontakton personin e afërt të përcaktuar në vendimin e gjykatës për përdorimin e ME-së.

2. Nëse subjekti kthehet në zonën e lejuar ose largohet nga zona e ndaluar brenda 30 minutave nga çasti që ai ose personi i afërt i tij kontaktohen nga salla operative, atëherë nuk ndërmerret asnjë veprim i mëtejshëm. Në këtë rast salla operative e evidenton këtë fakt në një regjistër të posaçëm.

3. Nëse subjekti dhe personi i afërt nuk mund të kontaktohen, salla operative njofton menjëherë Policinë e Shtetit, së cilës i përcjell informacionin për vendndodhjen e subjektit. Salla operative, brenda 24 orëve, njofton Shërbimin e Provës për shkeljen dhe veprimet e kryera prej saj në zbatim të këtij ligji.

4. Informacionet e marra në rastet e parashikuara nga ky nen ruhen për një periudhë gjashtëmuajore, duke filluar nga çasti i evidentimit të shkeljes. Prokurori ose gjykata mund të urdhërojë që informacionet të ruhen për një kohë më të gjatë se gjashtë muaj.

5. Nuk evidentohet si shkelje e kushteve të përdorimit të ME-së rasti kur Shërbimi i Provës i ka komunikuar me shkrim sallës operative autorizimin e lëshuar ndaj subjektit për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar. Autorizimi duhet të përmbajë përcaktimin e saktë të zonës ku lejohet të lëvizë subjekti dhe afatin e lejimit të lëvizjes.

6. Rregulla të hollësishme për kriteret e dhënies së autorizimeve përcaktohen me udhëzim të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 19

Shkelja e kushteve të ME-së

1. Policia e Shtetit dhe Shërbimi i Provës vënë në dijeni prokurorin menjëherë sapo marrin njoftimin për shkeljen e kushteve të ME-së.

2. Prokurori, kur vlerëson se janë shkelur qëllimisht, ose në mënyrë të përsëritur, kushtet për përdorimin e ME-së, harton një raport, të cilin ia paraqet gjykatës brenda 48 orëve nga marrja dijeni për shkeljen e kryer.

3. Raporti i hartuar në rastet e parashikuara nga pika 2 e këtij neni i paraqitet së njëjtës gjykatë që ka vendosur përdorimin e ME-së dhe përmban rekomandimin e Shërbimit të Provës për vazhdimin ose jo të ME-së ndaj subjektit që ka kryer shkeljen.

4. Gjykata dëgjon në seancë prokurorin, përfaqësuesin e Shërbimit të Provës e subjektin dhe, pasi vlerëson të gjitha rrethanat, vendos:

- a) vazhdimin e ME-së me të njëjtat kushte;
- b) sipas procedurës së parashikuar nga neni 260 i Kodit të Procedurës Penale ose neni 31 pika 10 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar;
- c) sipas procedurës së parashikuar nga neni 22 pika 2 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20
Fillimi i zbatimit të ligjit

1. Ligji, menjëherë pas hyrjes në fuqi, fillon të zbatohet ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 4 i këtij ligji, gjykimi i të cilave është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, të cilat urdhërojnë përdorimin e ME-së, pas informimit nga Shërbimi i Provës për mundësinë teknike të realizimit të saj.

2. Zbatimi i ligjit ndaj personave të parashikuar nga neni 4 i këtij ligji, që nuk janë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, fillon sipas afateve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të fondeve financiare të vëna në dispozicion për realizimin e mbikëqyrjes elektronike.

Neni 21
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 11 pika 3 dhe të nenit 20 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 12 pika 4 dhe të nenit 18 pika 6 të këtij ligji.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1.4.2012.

**Shpallur me dekretin nr.7219, datë 10.1.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**



LIGJ
Nr.10 495, datë 22.12.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7918, DATË 13.4.1995 “PËR MIRATIMIN ME
NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995 “PËR EMETIMIN DHE
SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË TË PRIVATIZIMIT)”, DHE TË
DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995 “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1030,
DATË 23.2.1995”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit)” dhe të dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995”, të ndryshuar”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 3, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:
“Afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2013.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7220, datë 10.1.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 496, datë 22.12.2011

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.4, DATË 14.12.2011
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.10 355, DATË
2.12.2010 “PËR BUXHETIN E VITIT 2011”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 14.12.2011, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.7221, datë 10.1.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.147, datë 22.12.2011

**PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË
LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)



VENDIM
Nr.148, datë 22.12.2011

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Miranda Ramaj zgjidhet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.149, datë 22.12.2011

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Riçard Marku zgjidhet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.150, datë 22.12.2011

PËR ZGJEDHJEN E AVOKATIT TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 61 të Kushtetutës, të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 pikat 1 dhe 7 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Igli Totozani zgjidhet në detyrën e Avokatit të Popullit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.7191, datë 20.12.2011

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Enkeleda Pëllumb Stawicki (Muskollari)
2. Hoara Genci Gjokutaj
3. Engi Genci Gjokutaj
4. Dorian Maks Lazri
5. Ylli Nevrus Koçi
6. Leonard Hamit Kuliçi
7. Nelton Haxhi Mebelli
8. Endri Ibrahim Dushaj
9. Fatos Luto Beqiraj
10. Claudia Artur Duka
11. Adriatik Namik Nanaj
12. Armando Qemal Opri
13. Ervin Petraq Dojçe (Dojce)
14. Donald Tanush Islami
15. Enkela Pellumb Duman (Kurti)



16. Artur Haxhi Agolli
17. Muhamet Murat Karaj
18. Altin Çerçis Zani
19. Enver Ramiz Tula
20. Etvjola Etëhem Wolf (Islamaj)
21. Farije Abdulla Geßner (Gjinia)
22. Arion Rahmi Baçi (Baci)
23. Eneida Muhamet Kupi (Mersini)
24. Jorgaq Jonuz Canga
25. Valbona Ismail Sohm (Pasha)
26. Florenca Zanun Çitozi
27. Iris Pal Sokoli
28. Olveola Selman Hehn (Elezi)
29. Teuta Haxhi Lapi
30. Anduela Fadil Cani-Köhn (Cani)
31. Elona Idriz Schmidt (Idrizi)
32. Gjergj Theodhor Duma

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr.16, datë 26.12.2011

**PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË TREGTIMIN E DREJTPËRDREJTË
DHE MASAT E SIGURISË**

Mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Palë e tretë” është çdo person fizik ose juridik i cili nuk është as subjekti i të dhënave, as kontrolluesi i të dhënave, as përpunuesi i të dhënave personale, as agjentët/punonjësit e kontrolluesit të të dhënave apo të përpunuesit të të dhënave.

2. “Tregtimi i drejtpërdrejtë” është komunikimi me çfarëdo mënyre, duke përfshirë në postë, faks, telefon, shërbimet on-line, i ndonjë reklamimi apo materiale të tregtimit, që kryhet nga vetë tregtari, drejtpërdrejt ose në emër të tij dhe e cila i drejtohet individëve të veçantë.

3. “Host Mailings” janë rastet kur kontrolluesi i të dhënave u dërgon material palëve të treta me anë të postës elektronike.

4. “Kontrollues i të dhënave” është çdo person fizik ose juridik, i cili përcakton dhe kontrollon qëllimet dhe mënyrat në të cilat përpunohen të dhënat personale.

5. “Subjekt i të dhënave” është çdo person fizik të cilit i përpunohen të dhënat personale.

KREU I MBLEDHJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Kontrolluesi mbledh të dhënat në mënyrë të ligjshme dhe informon subjektin e këtyre të dhënave.

2. Kontrolluesi siguron që subjektet e të dhënave janë të informuar për:

- identitetin e kontrolluesit;

- qëllimet e përpunimit;

- të drejtën e tyre për akses dhe për të korrigjuar të dhënat e pasakta që lidhen me të;

- të drejtën e tyre për të mos iu nënshtruar përpunimit të të dhënave për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë;

- të drejtën e tyre për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.

Informacioni në të dyja rastet e para është thelbësor dhe jepet në kohën e mbledhjes, pavarësisht nëse është i qartë nga konteksti i përpunimit ose subjekti i të dhënave e ka këtë informacion.

Kontrolluesi merr pëlqimin e subjektit, të cilit i përpunohen të dhënat personale për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të tërheqë pëlqimin e tij për tregtimin e drejtpërdrejtë në çdo kohë.

3. Trajtimi i situatave specifike

3.1 Në rastet kur të dhënat janë parashikuar të përdoren për tregtimin e drejtpërdrejtë, kontrolluesi sigurohet që subjekti i të dhënave është në dijeni të informacioneve sipas përcaktimeve në pikën 2.

Kontrolluesi jep këtë informacion në kohën e mbledhjes së të dhënave, por nëse kjo është e vështirë ose e pamundur për shkak të legjislacionit në fuqi, ky informacion jepet sa më shpejt të jetë e mundur.

3.2 Në rastin kur të dhënat do t’u përhapen palëve të treta, kontrolluesi siguron që subjekti i të dhënave është i informuar për:

- çdo marrës të të dhënave dhe qëllimin për të cilin të dhënat përhapen;

- të drejtat e tyre për të kundërshtuar përhapjen për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.

Ky informacion jepet në kohën e mbledhjes së të dhënave, por nëse kjo është e vështirë ose e pamundur për shkak të legjislacionit në fuqi, ky informacion të jepet përpara përhapjes së të dhënave te palët e treta.

4. Informacioni, në rastet e përdorimit të pyetësorëve dhe formave të tjera

4.1 Kontrolluesi siguron që subjektet e të dhënave janë të informuar nëse përgjigjet e pyetjeve të pyetësorëve janë të detyrueshme apo vullnetare dhe për pasojat në rast se nuk i përgjigjen pyetësorëve. Kontrolluesi siguron gjithashtu që nuk janë bërë pyetje të panevojshme. Informacioni në rastet e plotësimit të pyetësorëve jepet në kohën e mbledhjes.

KREU II MBLEDHJA NGA BURIME TË TJERA TË NDRYSHME NGA SUBJEKTI I TË DHËNAVE

1. Kur kontrolluesi nuk i mbledh të dhënat nga vetë subjekti, ai është i detyruar të ndërmarrë disa hapa për të siguruar që subjektet e të dhënave janë megjithatë në dijeni të informacionit që do të kishte pasur nëse do të kishte kontaktuar direkt me kontrolluesin e të dhënave.



2. Kontrolluesi e siguron informacionin e përmendur në pikën e mësipërme:
 - në kohën që bën regjistrimin/përpunimin e të dhënave; ose
 - kur njoftimi për përhapjen te palët e treta është bërë përpara se të bëhet përhapja, megjithëse subjekti i të dhënave ka qenë i informuar për këtë.
3. Kërkesat e përmendura më lart nuk aplikohen kur ato kërkojnë kosto të lartë financiare për të siguruar informacione të tilla ose kur është përmbushur ndonjë masë mbrojtëse shtesë.

KREU III MBLEDHJA E TË DHËNAVE SENSITIVE

1. Nëse mbledhja e të dhënave personale përfshin të dhëna sensitive, kontrolluesi kërkon pëlqimin e shprehur qartë të subjektit të të dhënave për mbledhjen dhe përpunimin e tyre.
2. Pëlqim i shprehur qartë është pëlqimi i dhënë me vullnetin e lirë nga subjekti dhe që nuk ka asnjë dyshim se ai e kupton veprimin që po kryen dhe pasojat që vijnë nga dhënia e tij dhe mundësinë për ta tërhequr atë në çdo kohë. Pëlqim i shprehur nuk do të thotë domosdoshmërisht në mënyrë të shkruar, përveç:
 - a) kur të dhënat janë bërë publike nga vetë subjekti i të dhënave;
 - b) nëse të dhënat janë përpunuar nga organizata jofitimprurëse me drejtim politik, filozofik, fetar ose sindikal. Nëse këto organizata i kanë përpunuar të dhënat pa pëlqimin e shprehur të subjektit të të dhënave, që përpunimi të jetë i ligjshëm, duhet të plotësojë këto kritere:
 - përpunimi bëhet për aktivitetin legjitim të organizatës;
 - ofrohen garancitë e duhura;
 - përpunimi lidhet vetëm me anëtarët e organizatës ose personat që kanë lidhje të rregullta me të;
 - përpunimi bëhet lidhur me qëllimet e organizatës jofitimprurëse;
 - të dhënat të mos përhapen te palët e treta pa pëlqimin e subjektit të të dhënave.
3. Nëse nuk ndodhemi në rrethanat e mësipërme, kontrolluesit i përdorin të dhënat në atë mënyrë që nuk prek të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave.
4. Kur të dhënat sensitive të mbledhura në lidhje me veprimtarinë e tregtimit të drejtpërdrejtë, përpunohen më tej për qëllime statistikore, ato bëhen anonime ose transformohen, në mënyrë të tillë që nuk lejojnë identifikimin e subjektit të të dhënave, përveç kur kontrolluesi ka marrë pëlqimin e shprehur të subjektit.

KREU IV PËRPUNIMI PËR QËLLIME TË NDRYSHME

1. Nëse kontrolluesi përpunon të dhënat për qëllime të ndryshme nga ai për të cilin janë mbledhur, të verifikohet nëse qëllimi i ri përputhet me qëllimin e parë. Nëse ka përputhshmëri, përpunimi i ri lejohet, në të kundërt, përpunimi i ri lejohet vetëm në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në shqyrtimin e përputhshmërisë së qëllimit të parë me qëllimin e ri, kontrolluesi i të dhënave mban parasysh këto kritere:
 - a) nëse qëllimi i ri është thelbësisht i ndryshëm nga qëllimi i mbledhjes;
 - b) nëse subjekti i të dhënave ka kundërshtuar përpunimin për qëllimin e ri;
 - c) legjislacionin në fuqi dhe rastet e shqyrtuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU V MBAJTËSIT E SERVERIT TË E-MAIL-IT (HOST MAILINGS)

Kontrolluesi, në rastet e mbajtësit të serverit të e-mail-it (Host Mailings), të jetë i identifikueshëm qartësisht.

Nuk përdoren kriteret përzgjedhëse që kanë një efekt të dëmshëm mbi të drejtat e subjektit të të dhënave.

KREU VI PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PËR TË MITURIT

1. Në mbledhjen e të dhënave të të miturit, kontrolluesi siguron që prindi ose kujdestari i tij ligjor janë të informuar për qëllimet e përpunimit të të dhënave.

Në rastet kur të miturve u drejtohen materiale në fushën e biznesit ose kur mblidhen të dhëna nga të miturit, informacioni të jetë i dukshëm, i lexueshëm dhe i kuptueshëm nga ata.

2. Kur kërkohet pëlqimi i të miturit për përpunimin, kontrolluesi i të dhënave merr pëlqimin e qartë e të shprehur nga prindi i të miturit ose kujdestari i tij ligjor.

3. Prindi ose kujdestari ligjor i të miturit gëzon të njëjtat të drejta që ka i mituri si subjekt i të dhënave. Kontrolluesi verifikon nëse personi që ushtron të drejtat e të miturit është prindi ose kujdestari ligjor i tij.

4. Kontrolluesi, në rastet kur i mituri merr pjesë në një lojë, për çmimin e ofruar ose çdo veprim tjetër që kërkon përhapjen e të dhënave të tij, mbledh vetëm të dhënat e mjaftueshme për të marrë pjesë në këtë veprimtari.

KREU VII PËRGJEGJËSITË

1. Kontrolluesi, nëse punëson përpunues për përmbushjen e qëllimit të tij, lidh një kontratë me këtë të fundit për të parashikuar instruksionet. Përgjegjësia për këtë lloj përpunimi bie mbi kontrolluesin dhe nuk transferohet me kontratë te përpunuesit.

KREU VIII MASAT E SIGURISË

1. Kontrolluesit përdorin masa të përshtatshme sigurie, duke mbajtur parasysh kostot dhe gjendjen e teknologjisë, mënyrën e implementimit dhe sensitivitetin e informacionit për të parandaluar çfarëdolloj humbjeje ose shkatërrimi aksidental, përhapjen ose aksesin e paautorizuar të të dhënave personale. Për një siguri më të madhe kontrolluesit duhet të ndërmarrin masa specifike sigurie.

2. Këto masa të përmbajnë përveç të tjerave, sigurinë e ndërtesave në të cilat mblidhen të dhëna personale (përfshirë dhe hyrjet e ndërtesave), listën e personave të autorizuar për të pasur akses në të dhënat, mekanizma të përshtatshëm, masa sigurie për transferimet e të dhënave ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit të të dhënave.

3. Kontrolluesit të sigurohen që çdo përpunues që ato kontraktojnë të garantojë masa të përshtatshme sigurie.



KREU IX PËRHAPJA E LISTAVE TË TË DHËNAVE TË MBLEDHURA

1. Kontrolluesit të cilët përhapin listat e tyre të të dhënave tek organizata të tjera duhet të njihen paraprakisht me qëllimet e përdorimit të të dhënave.

2. Kontrolluesit bëjnë një marrëveshje të shkruar me përdoruesit e ardhshëm (palën e tretë), me anë të së cilës kjo e fundit merr përsipër të respektojë parimet e përmendura në këtë udhëzim, të përdorura përpara përhapjes së të dhënave.

KREU X KËRKESAT E SUBJEKTEVE

1. Aksesit në të dhëna:

a) Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë që të kërkojë nga kontrolluesi i të dhënave:

- konfirmimin nëse të dhënat e lidhura me të po përpunohen ose jo, qëllimet e përpunimit, kategoritë e të dhënave që përpunohen, kategoritë e marrësve ose të atyre të cilëve u përhapen këto të dhëna;

- komunikimin në një formë të kuptueshme lidhur me procesin e përpunimit dhe informacionet lidhur me burimin e tyre;

- informacion lidhur me logjistikën e përdorur në përpunimin automatik dhe rastet e vendimmarrjes automatike.

b) kontrolluesi, i cili merr një kërkesë nga subjekti i të dhënave:

- merr informacione plotësuese lidhur me identitetin e kërkuarit dhe sigurohet se subjekti legjitimohet të ketë akses në të dhëna;

- i përgjigjet kërkesave të subjektit në një mënyrë të kuptueshme duke dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm.

KREU XI BURIMET E TË DHËNAVE

Kur kontrolluesi merr një kërkesë në formë të shkruar ose në çfarëdo forme tjetër, nga subjekti i të dhënave, ku kërkohet burimi i të dhënave të mbledhura, kontrolluesi vlerëson ligjshmërinë e kërkesës. Nëse kërkesa është e ligjshme dhe nëse burimi mund të identifikohet me mjete të arsyeshme, ia komunikon këtë informacion subjektit të të dhënave. Nëse të dhënat janë mbledhur nga disa burime, kontrolluesi mban listën e këtyre burimeve.

KREU XII TË FUNDIT

Janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)

VENDIM
Nr.123, datë 25.11.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLAT E ALOKIMIT TË
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, kapitullit 11 të “Rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve”, miratuar me vendimin nr.13, datë 22.2.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2011, pasi shqyrtoi shkresat e shoqërisë OST sh.a., nr.2033 Prot., datë 25.7.2011 dhe nr.2110 Prot., datë 29.7.2011, shkresat e KESH sh.a., dhe “CEZ shpërndarje” sh.a., përkatësisht me nr.3923 Prot., datë 17.8.2011 dhe nr. 4151/1, Prot. datë, 18.8.2011, dhe shkresat e AEES nr.28, datë 5.9.2011 dhe nr.27, datë 31.8.2011, në lidhje me rregullat “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstaton se:

- Për kërkesën e OST sh.a., për të rishikuar “Rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit” për shkak të pamundësisë së kryerjes së ankandëve ditore për alokimin e të drejtës së përdorimit të kapacitetit disponibël të interkonjeksionit, për shkak të mosdisponimit të platformës elektronike (Softin) për menaxhimin e tregut, Bordi i Komisionerëve vëren se periudha kohore në të cilën mbahet ankandi ditor është shumë e shkurtër nga ora 13:51 deri në orën 14:30, si të tillë problemi kryesor qëndron në mungesën e softit të OST sh.a., për të kryer këto ankande.

- Për kërkesat e KESH sh.a. dhe “CEZ shpërndarje” sh.a., përkatësisht me nr.3923 Prot., datë 17.8.2011 dhe nr.4151/1, Prot., datë 18.8.2011, për rishikimin e rregullave “Për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”, me qëllim zgjatjen e periudhës transitore deri në 31.12.2012, bazuar në argumentimet si më poshtë:

Argumentime të “CEZ shpërndarje” sh.a.:

- Sigurimi i detyrimit të shpërndarësit të energjisë për të importuar lirshëm energjinë elektrike për humbjet në maksimumin e garantuar të kapaciteteve të interkonjeksionit pa asnjë kosto shtesë.

- “CEZ shpërndarje” ka hapur tenderin vjetor me të drejta të siguruara dhe mendon se heqja e kësaj të drejte mund të çojë në rritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike dhe për pasojë do të çonte në anulimin e tenderit.

- “CEZ shpërndarje” konsideron si risk dhe mundet që nga kompanitë pjesëmarrëse në ankandin e kapaciteteve të blejnë ato dhe të bllokojnë pjesëmarrësit e tjerë të mundshëm fitues.

Kërkesa e KESH sh.a. bazohet në ndryshimet që kanë ndodhur nga koha e miratimit të “Rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit” e deri më tani dhe konkretisht sipas KESH sh.a.:

- Koha kur u miratuan rregullat, i korrespondonte një cikli të mirë hidrik, ndërkohë tani ka nisur një cikël i thatë hidrik.

- Eksperienca e deritanishme e prokurimeve të KESH sh.a., ka treguar se ka më shumë konkurrencë kur ofertohet me të drejta të siguruara nga KESH sh.a.

Në lidhje me këto argumente të “CEZ shpërndarje” apo të KESH sh.a., theksojmë se “Rregullat e alokimit të kapaciteteve” janë miratuar më datë 22.2.2011, dhe nuk ka kuptim që “CEZ shpërndarje” të hapë tenderin me të drejta të siguruara, kur prej kohësh është në dijeni të mospasjes së këtyre të drejtave pas datës 31.12.2011. Përsa i përket riskut potencial të bllokimit të kapaciteteve



nga pjesëmarrës të tjerë, sqarojmë së “CEZ shpërndarje” sikurse çdo pjesëmarrës i tregut, përfshirë edhe KESH sh.a., është i lirë të marrë pjesë në këto ankande dhe të sigurojë kështu kapacitetet e nevojshme. Po ashtu, lidhur me këtë shqetësim të bllokimit të kapaciteteve, në rregullore është parashikuar në kapitullin VII paragrafi 4, se e drejta e përdorimit të kapacitetit ndërkufitar ekzekutohet në bazë të principit “përdore ose humbe”. Dhe më tej në paragrafin 7, përcaktohet se në rast se zotëruesi nuk e përdor kapacitetin e deklaruar tek OST, atëherë ai nuk do të lejohet të marrë pjesë në ankandin e muajit pasardhës. Në paragrafin 8 përcaktohet se në rast se zotëruesi i kapacitetit në mënyrë sistematike nuk e përdor kapacitetin e deklaruar tek OST, atëherë ai nuk do të lejohet të marrë pjesë në ankandet e 6 muajve pasardhës. Nga ana tjetër, nëse do të pranoheshin argumentet e KESH sh.a., apo edhe “CEZ shpërndarje”, do të thotë që këto të drejta të siguruar të aplikohen gjithmonë dhe jo për periudha tranzitore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Në “Rregullat e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve”, të miratuara me vendimin nr.13, datë 22.2.2011, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1.1 Në fund të paragrafit të katërt të kapitullit 1 “Hyrje dhe dispozita të përgjithshme” të “Rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit, shtohet paragrafi me përmbajtjen:

“Në lidhje me ankandin ditore të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit nga secili drejtim, shoqëria OST sh.a., në mungesë të platformës elektronike (softit), por jo më vonë se data 31 mars 2012, do të ofrojë kapacitete ditore për të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë proporcionale sipas kërkesave. Menjëherë pas sigurimit të platformës elektronike (softit), gjatë periudhës tranzitore, OST sh.a. duhet të njoftojë ERE-n”. OST të parashikojë në planin e investimeve për vitin 2012 fondin për realizimin e prokurimit dhe vendosjes në punë të softit brenda afatit të vendosur në këtë dispozitë.

2. Duke filluar nga data 1 janar 2012 shfuqizohen të gjitha të drejtat e rezervuara. OST nuk mund të bëjë alokim kapacitetesh mbi baza prioritare (të drejta të siguruar).

3. Për një periudhë tranzitore, por jo më vonë se data 1 korrik 2012, OST do të alokojë kapacitetet mbi bazën e ankandit mujor. Jo më vonë se data 1 korrik 2012, OST do të ketë kryer ankandin për periudhën e mbetur të vitit 2012. Për periudhën që nga data 1 janar 2013, OST do të kryejë ankande vjetore për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., KESH sh.a., “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe AEES për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.155, datë 19.12.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR
PËRJASHTIMIN NGA AKSESI I PALËVE TË TRETA TË PARAQITUR NGA ANA E
KOMPANISË TAP**

Në mbështetje nenit 40 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenit 18, germa “e”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesin i palëve të treta, të paraqitur nga ana e kompanisë TAP.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë kompaninë TAP për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.156, datë 19.12.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “STRAVAJ
ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA
HEC STRAVAJ**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Stravaj” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Stravaj” sh.a. plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes (pika 4.1.5 e nenit 9), është në proces miratimi.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec Stravaj” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Stravaj.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM **Nr.157, datë 19.12.2011**

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HEC STRAVAJ ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pikat 1, germa a, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Stravaj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Stravaj” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin teknik (nenin 9, pika 4.10), që ka të bëjë me sasinë e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar; kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit dhe listën e kontratave të mëparshme të realizuara, nuk është dhënë asnjë informacion nga ana e subjektit.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hec Stravaj” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.158, datë 19.12.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SALILLARI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA HEC “VERTOP”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Salillari” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 të nenit 9 (pikat e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes dhe leja mjedisore nga organet përkatëse), janë në proces.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vertop”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.159, datë 19.12.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HYDRO SALILLARI” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pikat 1 germa a, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hydro Salillari” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.160, datë 19.12.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PV10K, NR. 104, LËSHUAR ME VENDIM TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.51, DATË 5.7.2010 PËR SHOQËRINË
“WENERG” SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4, gjerat “a” dhe “b” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për ndryshimin e licencës nr.104, Seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.51, datë 5.7.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Wenerg" sh.a., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15 pika 4 germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.
- Neni 15 pika 4 germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr.104, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Dardha 1” me fuqi 4 Mw, të shoqërisë “Wenerg” sh.a., të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.51, datë 5.7.2010.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.161, datë 19.12.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.12.2011, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorive Teknike për rishikimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.1.2012
Doli nga shtypi më 18.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtre
Tiranë, 2012

Çmimi 32 lekë